



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 11.06.2019
Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.157/2013, “PËR MASAT KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Drejtuar: Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në mbledhjet e datave 10.06.2019 dhe 11.06.2019 në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator deputeti Luan Duzha.

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja e sistemit financiar dhe e ekonomisë në tërësi nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar për paqen, sigurinë si dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të fushës.

II. OBJEKTIVAT E PROJEKTLIGJIT

Objektivat e këtij projektligji janë :

- zvogëlimi i rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit;

- parandalimi i hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë të tjerë ose zbulimi dhe raportimi i tyre;
- zbulimi dhe goditja e kërcënimeve për pastrim të parave/financim terrorizmi.

III. ÇËSHTJET KRYESORE QË TRAJON PROJEKTLIGJI

Projektligji përbëhet nga 12 nene dhe ndryshimet e tij konsistojnë, si më poshtë vijon.

Neni 1 i projektligjit , ndryshon nenin 3, ku në pikat 1 e 2, zgjerohet koncepti i bllokimit të përkohshëm në përputhje me kriteret e vendosura nga rekomandimet e FATF-së, për të siguruar që masat e marra në rast bllokimi/sekuestrimi përfshijnë edhe ndalimin e dhënies së shërbimeve financiare dhe se aplikohet ndaj të gjitha llojeve të pasurive;

Neni 2 i projektligjit , ndryshon nenin 6, ku në pikën 4, pas fjalisë së parë shtohen “Të njëjtat masa merren edhe për fondet dhe pasuritë e tjera,:

- a) në të cilat personi i shpallur ushtron të drejta kontrolli faktike;
- b) që zotërohen apo kontrollohen nga personi i shpallur, duke mos i kufizuar masat për fondet dhe pasuritë e tjera që mund të lidhen me një akt terrorist specifik, komplot apo kërcënim;
- c) që janë individualisht apo bashkërisht të zotëruara apo kontrolluara, direkt apo indirekt, nga persona të shpallur;

ç) të rrjedhura apo prodhuara nga fondet ose pasuritë e zotëruara apo të kontrolluara, direkt apo indirekt nga personat e shpallur;

d) të personave që veprojnë për llogari apo nën drejtimin e personave të shpallur.”, përmbajtja e së cilës synon që detyrimi për bllokim të përfshijë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe elemente të tjera të fondeve apo pasurive të tjera, të zotëruara apo kontrolluara në mënyrë indirekte apo në dispozicion të personave të shpallur, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së.

Neni 3 i projektligjit, i cili ndryshon nenin 10, ndryshohet në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së.

Neni 4 i projektligjit , pas nenit 10, shtohet neni 10/1, për të garantuar zbatimin pa vonesë (që tanimë interpretohet si çështje orësh dhe që duhet të gjejë zbatim menjëherë) të sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në lidhje me terrorizmit dhe/ose financimin e tij, element ky që është vlerësuar ende problematik nga Komiteti Moneyval.

Neni 5 i projektligjit, i cili ndryshon nenin 14:

- shkurtton afatet e zbatimit të rezolutave;
- saktëson detyrimin për nxjerrje urdhri bllokimi nga ministri përgjegjës për financat, nëse ka të dhëna për ekzistencën e tyre brenda vendit;
- shtohet një pikë, që synon saktësim të procedurave dhe standardeve që do të ndiqen, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.5, shkronja “b”).

Neni 6 i projektligjit , i cili ndryshon nenin 15, zgjerohet koncepti i përfshirjes së personave të dyshuar si dhe shtohet pika 1/1, që synon sqarim procedure dhe lidhje me pikën 2, të nenit 5, të ligjit.

Neni 7 i projektligjit, i cili ndryshon nenin 15:

- pika 1 ndryshohet, duke hequr diskrecionin për nxjerrjen e urdhrin nga ministri i ngarkuar, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.4);
- pika 2 ndryshohet, duke shtuar afatin e urdhrin të bllokimit, me synim që të paraprihet çdo lloj problematike apo situatë sipas të cilës vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave nuk miratohet në kohë, duke rrezikuar lirimin e fondeve të bllokuara.

Neni 8 i projektligjit , i cili ndryshon pikën 4 të nenit 18, me synim që:

- afatet për njoftim të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të jenë të njëjta, sipas kërkesave të rezolutave të komiteteve përkatëse;
- të ndiqen procedurat dhe formularët standarde, siç janë miratuar nga Komitetet përkatëse, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF (kriteri 6.1 shkronja “d”);
- të sigurohet sa më shumë që të jetë e mundur informacioni identifikues dhe informacioni të posaçëm që mbështet shpalljen, kur i kërkohet një vendi tjetër njohja e masave të nisura nën mekanizmin e bllokimit, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.2, shkronja “e”)

Neni 9 i projektligjit, ndryshon pikat 2 dhe 3 të nenit 21, duke shkruar afatet e verifikimeve, nisur nga konstatimi për veprime jo në kohë, për implementim të sanksioneve, të evidentuara në Raportin e Moneyval.

Neni 10 i projektligjit, ndryshon nenin 23, ku shtohet pika 3/1, duke saktësuar procedurën e lejimit të shpenzimeve, sipas këtij neni.

Neni 11 i projektligjit, ndryshon nenin 25, ku :

- në pikën 1, fjalët fjalët “... ose mbështetur në kërkesën e personit të shpallur,” zëvendësohen me “... kërkesën e personit të shpallur ose të personit të cenuar gabimisht,”;
- pas shkronjës “dh”, të pikës 4, shtohet shkronja “e”, “e) për shkak të kërkesës së bazuar të personave të prekur gabimisht nga masat e parashikuara në këtë ligj,” që synojnë parashikimin e procedurave për zhbllokimin e fondeve të personave të cenuar gabimisht, në përputhje me rekomandimin 6 të FATF (kriteri 6.6 shkronja “f”);
- pas pikës 4 shtohen pikat 4/1 dhe 4/2. Ndryshimet synojnë vendosjen e procedurave për paraqitjen pranë komiteteve përkatës të OKB-së, të kërkesave për heqje nga lista të personave apo enteve të shpallur, sipas regjimit të sanksioneve të OKB-së, të cilët, sipas vlerësimit të vendit nuk plotësojnë kriteret për shpallje, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.6, shkronja “a”);
- në pikën 5, shkurtrohet afati për kthimin e pasurive të sekuestruara, në përputhje me rekomandimin 6.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË KUSHTETUESE DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI DHE AKTET NDËRKOMBËTARE.

Projektligji që propozohet për miratim është në përputhje me nenin 78 dhe 116, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me nenin 26, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe në pikën 3, të Rregullores së Këshillit të Ministrave, miratuar me vendimin nr.584, datë 28.8.2003, të ndryshuar.

V. DISKUTIME NË KOMISIONIN PËR SIGURINË KOMBËTARE

Për prezantimin e projektligjit, ishin ftuar Zëvendësministri për Financat dhe Ekonominë Z. Elton Haxhi, Drejtori i Përgjithshëm i Parandalimit dhe Pastrimit të Parave Z. Elvis Koçi, Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara Z. Artur Kala, si dhe Drejtori i Drejtorisë së Përputhshmërisë dhe Teknologjisë së Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave Z. Agim Muslia.

Gjatë fjalës së tij Z. Haxhi theksoi se ky projektligj është paraqitur në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) të Këshillit të Evropës. Ai vjen si një paketë së bashku edhe me disa ligje të tjera të cilat gjithashtu adresojnë rekomandimet e kësaj strukture lidhur me masat që duhet të ndërmerren vendi ynë në kundër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, reduktimit të informalitetit, transparencës, adresimin e problematikave dhe mundësimin e mbrojtjes së sistemit financiar nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, forcimin e integritetit të sistemit parandalues në vend, zvogëlimin e mundësisë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit nëpërmjet politikave koherente, parandalimin e hyrjes në vendin tonë të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar etj.

Relatori i këtij projektligji z. Duzha, vuri theksin në rëndësinë e këtij projektligji në kuadër të masave që Qeveria Shqiptare po ndërmerr së bashku me gjithë paketën e projektligjeve lidhur me masat që duhet të ndërmerren vendi ynë në kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Z.Duzha gjatë relatimit të tij prezantoi disa nga objektivat e projektligjit të cilat konsistojnë në:

- Vijimin e përafrimit të plotë të legjislacionit me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar dhe plotësimi i tij duke mundësuar zbatimin nga Republika e Shqipërisë të detyrimit që rrjedh nga neni 13 i Konventës nr. 198 të KiE, “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit” ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9646 datë 27.11.2006.
- Parandalimi i hyrjes së fondeve në mbështetje të terrorizmit dhe zbulimi i pasurive dhe fondeve të mbajtura nga personat e shpallur dhe ndalimet;

- Implementimi dhe zbatimi i sanksioneve financiare specifike në përputhje me procedurat dhe standardet e Metodologjisë së FATF;
- Bllokimi pa njoftim paraprak I fondeve dhe pasurive e personave të shpallur, përcaktimi i mekanizmave për identifikimin e subjekteve potencial për shpallje sipas kritereve të Rezolutave, mundësimin e ndjekjes së procedurave dhe formularëve standarde për listim të miratuara nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit;
- Implementimi pa vonesë i sanksioneve financiare specifike dhe vendosja e procedurave të heqjes nga lista dhe të zhblokimit të fondeve dhe pasurive të subjekteve të cilët nuk plotësojnë/nuk plotësojnë më, kriteret për shpallje;

VI. PËRFUNDIME

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, duke vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji i cili vjen në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Evropës, me shumicën e votave të gjithë anëtarëve të pranishëm miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

RELATOR

KRYETARE

LUAN DUZHA

ERMONELA VALIKAJ (FELAJ)

